

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6245
E shtunë, 20 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Kurti: Nuk i shmangim bisedimet me Serbinë, por së pari drejtësi dhe punësim | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", QEMAJL MUSTAFA | FAQE 4-5

PDK-ja DUHET TË REFLEKTOJË KARSHI REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE



Kryetari i Degës i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan, Qemajl Mustafa, ka thënë se kjo parti duhet ta analizojë kujdesshëm rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se duhet të gjenden rrethanat që shkaktojnë rezultatin e së dielës. Sipas tij, PDK-ja duhet të reflektojë. Mustafa ka bërë me dije se këtij subjekti politik i duhet një rirreshtim i mirëfilltë i vlerave brenda saj. Ai ka vlerësuar se PDK-ja për kohë të gjatë është udhëhequr nga njerëzit që kurrë nuk i kanë fituar komunitatet e tyre. Sipas tij, dikush tjetër mblidhte vota e dikush tjetër qeveriste dhe kishte pushtet të pakufishëm rreth liderit

REFUZOHEN MBI 3 000 FLETËVOTIME NGA DIASPORA

 | FAQE 3

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se 3 435 zarfe me fletëvotime nga diaspora janë refuzuar. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë të mbajtur në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka thënë se deri më tani, nga 11 653 pako të supozuara me fletëvotime që i janë nënshtruar procesit të vlerësimit, janë aprovuar 8 212 zarfe me fletëvotime, ndërsa janë refuzuar 3 435. Ai ka thënë se arsyet e refuzimit të tyre janë të ndryshme



BRENDË 24 ORËVE DHJETË TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË

 | FAQE 5

OPINION

PAS ZGJEDHJEVE TË GJITHË ANALISTËT BËHEN TË MENÇUR... EDHE UNË | F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



RINDËRTIMI I NJË BESIMI TË HUMBUR | F. 11

Ismet HAJRULLAHU



AKTUALE

AAK-ja VLERËSON LART PROCESIN ZGJEDHOR | F. 9



EKONOMI



NGA SKEMA E NDIHMËS SOCIALE PËRFITUAN 25 679 FAMILJE | F. 8

FMN-JA VLERËSON MASAT E NDËRMARRA NGA BQK-ja PËR TEJKAJIMIN E KRIZËS NGA PANDEMIA | F. 8

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja me projekt të ri për ta ndihmuar vaksinimin në Ballkan

PRISHTINË, 19 SHKURT - Bashkimi Evropian ka njoftuar për nisjen e një projekti të ri për t'i ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor për imunizimin e popullatës kundër koronavirusit të ri. Sipas një njoftimi të Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, projekti është në vlerë të mbi 7 milionë eurove dhe do të realizohet në partneritet me Organizatën Botërore të Shëndetësisë. "Me këtë projekt të ri që në partneritet me OSh-në mbështet fushatat e vaksinimit në Ballkanin Perëndimor, BE-ja vazhdon ta përmbushë

zotimin e saj për t'i mbështetur partnerët tanë për trajtimin e pandemisë që nga fillimi i saj. Projekti i shtohet paketës sonë prej 70 milionë eurosh për ta mbështetur qasjen në vaksina për rajonin dhe për t'i siguruar pajisjet e nevojshme për fushatat", citohet të ketë thënë komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi. Vetë Bashkimi Evropian është përballur me vonesa të furnizimeve me vaksina kundër koronavirusit. Disa vende anëtare kanë kritikuar Komisionin Evropian për vonesat.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka pranuar gabimet në strategjinë për të siguruar vaksina të mjaftueshme për 447 milionë qytetarët e Bashkimit Evropian. "Ne ende nuk jemi ku duam të jemi. Kemi qenë të vonshëm në autorizim. Ne kemi qenë shumë optimistë kur kemi pasur të bëjmë me prodhim masiv dhe, ndoshta, kemi pasur shumë vetëbesimin se ajo që e kemi porositur mund të dërgohej në kohë", ka thënë von der Leyen para Parlamentit Evropian më 10 shkurt.



Çfarë parasheh projekti i ri i BE-së për Ballkanin Perëndimor

Sipas njoftimit, ky projekt do të ndihmojë në përgatitjet e rajonit për administrimin efektiv të vaksinave Covid-19, përfshirë ato të marra nga COVAX dhe përmes mekanizmit të BE-së për ndarje të vaksinave me

shtetet anëtare të BE-së. "Kjo do të ndihmojë edhe për përmirësimin e qëndrueshmërisë së rajonit ndaj emergjencave shëndetësore, si dhe do ta mbështesë rajonin në lëvizjen

drejt financimit të qëndrueshëm për kujdesin shëndetësor universal", thuhet në njoftim. Paketa totale e ndihmës së BE-së për Ballkanin Perëndimor për reagimin ndaj Covid-19

aktualisht i tejkalon 3.3 miliardë euro, ka njoftuar më herët Komisioni Evropian. Kjo ndihmë përfshin mbështetjen e menjëhershme me pajisje, mbështetjen afatmesme dhe afatgjatë për sistemet

shëndetësore dhe ekonomitë, mbështetjen për bizneset përmes bankave lokale, ndihmën makro-financiare në formën e kredive, dhe një paketë reagimi të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI).

ShBA-ja zyrtarisht i ribashkohet Marrëveshjes së Parisit

UASHINGTON, 19 SHKURT - Shtetet e Bashkuara zyrtarisht i janë ribashkuar Marrëveshjes së Parisit për klimën, vetëm një muaj pasi presidenti amerikan Joe Biden u tha Kombeve të Bashkuara, në ditën e parë si president, se Uashingtoni dëshiron që sërish të jetë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Rikthimi në Marrëveshjen për klimën më 19 shkurt u mirëprit nga liderët botërorë, duke theksuar se tani fokusi do të jetë në atë se cilat janë planet e ShBA-së për t'i zvogëluar nivelet e gazrave serrë, në përpjekje për ta luftuar ngrohjen globale. I dërguari i posaçëm i ShBA-së



për klimën, John Kerry, së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, do të marrin pjesë në hapjen e

Samitit për angazhim global, për ta shënuar edhe rikthimin e ShBA-së në këtë marrëveshje. Guterres deklaroi më 8 shkurt

se ripranimi i ShBA-së "në vetvete është shumë i rëndësishëm", ndërkaq shefja e OKB-së për klimën, Christiana Figueres, tha se është humbur shumë kohë në trajtimin e ndryshimeve klimatike, pa pjesëmarrjen e ekonomisë më të madhe në botë në Marrëveshjen e Parisit. Ish-presidenti amerikan Donald Trump më 2017 deklaroi se Uashingtoni do të largohet nga marrëveshja, duke argumentuar se pjesëmarrja në këtë marrëveshje do të sillte disavantazh ekonomik. Vendimi për tërheqjen e ShBA-së nga marrëveshja zyrtarisht hyri në fuqi më 4 nëntor 2020,

vetëm një ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale, ku Bideni mposhti Trumpin. Që atëherë, ShBA-ja vazhdoi të punonte për zvogëlimin e emetimeve të dyoksidit të karbonit, por pa përkrahjen e qeverisë federale. Vendimi për t'iu bashkuar marrëveshjes po shihet si mundësi për ShBA-në që të ketë një qasje më të unifikuar ndaj ndryshimeve klimatike. Administrata Biden tha se do të njoftojë për synimet e saj për zvogëlimin e emetimeve në Ditën e Tokës në muajin prill. Mbi 120 shtete janë zotuar se deri në mesin e këtij shekulli do të kenë zero emetime të karbonit.

Qipro akuzon Turqinë për rritjen e numrit të azilkërkuesve

ANKARA, 19 SHKURT - Qiproja akuzoi Turqinë për krijimin e një rruge të re për migrantët, e cila ka ngarkuar këtë vend me përqindjen më të lartë të azilkërkuesve në Bashkimin Evropian. Në muajt e fundit, Qipro është përballur me rritje të numrit të azilkërkuesve. Ky vend është anëtar i Bashkimit Evropian që nga viti 2004. "Turqia është origjina e shumicës së flukseve të azilkërkuesve. Ky vend nuk

po arrin t'i zbatojë të gjitha marrëveshjet në lidhje me migrimin drejt Qipros", ka njoftuar Ministria e Jashtme dhe ajo e Brendshme e Qipros, në një deklaratë të përbashkët, raporton AFP. Deklarata i bëri thirrje Komisionit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare të ndihmojnë vendin për të ndaluar flukset e paligjshme të migrantëve dhe për të siguruar kthimet e ligjshme. Rreth 3.6 milionë refugjatë



sirianë gjenden në Turqi. Në vitin 2016, Bashkimi Evropian arriti marrëveshje me

Turqinë për ndaljen e rrjedhës së migrantëve në Evropë. Ankara kishte marrë përsipër

të pranonte përsëri migrantët që nuk kishin të drejtë për mbrojtje ndërkombëtare, në këmbim të miliarda eurove ndihmë. BE-ja në dhjetor të vitit 2020 tha se i kishte ndarë Turqisë gjashtë miliardë euro të premtuara në vitin 2016. Paratë e BE-së janë caktuar për projekte të veçanta sociale brenda Turqisë për të ndihmuar refugjatët dhe ato nuk do t'i paguhet drejtpërdrejt qeverisë turke.

Refuzohen mbi 3 000 fletëvotime nga diaspora

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se 3 435 zarfe me fletëvotime nga diaspora janë refuzuar. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë të mbajtur në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka thënë se deri më tani, nga 11 653 pako të supozuara me fletëvotime që i janë nënshtruar procesit të vlerësimit, janë aprovuar 8 212 zarfe me fletëvotime, ndërsa janë refuzuar 3 435. Ai ka thënë se arsyet e refuzimit janë të ndryshme

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se 3 435 zarfe me fletëvotime nga diaspora janë refuzuar. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë për media mbajtur në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka thënë se deri më tani, nga 11 653 pako të supozuara me fletëvotime që i janë nënshtruar procesit të

vlerësimit, janë aprovuar 8 212 zarfe me fletëvotime, ndërsa janë refuzuar 3 435. Ai ka thënë se arsyet e refuzimit të tyre janë të ndryshme. "Disa prej këtyre pakove janë dërguar nga persona që nuk janë të regjistruar si votues jashtë Kosovës, gjatë periudhës së aplikimit. Po ashtu, disa prej tyre janë dërguar nga persona që janë refuzuar në periudhën e aplikimit. Rastet e tjera të refuzuara kanë të bëjnë me faktin se ato janë dërguar nga votues të pidentifikuar, apo ka

pasur votim grupor", ka deklaruar Elezi. Ai ka folur edhe për procesin e rinumërimit të votave në 12 vendvotime në disa komuna. Rinumërimi duhet të bëhet pasi gjatë pranimit të materialit zgjedhor, fletëvotimet nga këto vendvotime nuk kanë mundur të pranohen si të rregullta. "Rinumërimi i tyre do të bëhet gjatë ditës së sotme. Pas orës 14:00 besoj se do të përmbyllet ky proces, ndërkaq sa i përket mundësisë që të ketë sërish rinumërim të vendvotimeve të tjera, me rekomandim të QNR-së, ne nuk mund ta përjashtojmë këtë, për faktin se ka vendvotime të cilat janë në procesin e auditimit aktualisht dhe duhet ta presim procesin e auditimit për të parë nëse do të ketë nevojë për rinumërim", ka deklaruar Elezi.

Ende nuk ka një datë të saktë se kur do të nisë procesi i numërimit të votave të ardhura me postë nga diaspora në Kosovë për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare që janë mbajtur më 14 shkurt. Përveç votave nga diaspora, KQZ-ja nuk ka nisur as procesin e numërimit të votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta.

Në bazë të rezultateve preliminare, zgjedhjet e 14 shkurtit i ka fituar Lëvizja Vetëvendosje, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës.



Kurti: Nuk i shmangim bisedimet me Serbinë, por së pari drejtësi dhe punësim

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një intervistë për "Zërin e Amerikës" tha se nuk i nënçmon bisedimet me Serbinë, por nuk mund t'i shndërrojë ato në përparësi të punës së qeverisë së ardhshme. Partia e Kurtit i ka fituar zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë. "Ne nuk duam ta evitojmë dialogun e ta nënçmojmë rëndësinë e tij, mirëpo konsiderojmë se qytetarët e Republikës së Kosovës na kanë zgjedhur për të sjellë drejtësi dhe punësim. Dhe, natyrisht, se është urgjente të merremi me pandeminë Covid-19", ka thënë Kurti.

Një qeveri koalicioni e udhëhequr nga Kurti, vitin e kaluar, ka zgjatur vetëm 51 ditë, pasi është rrëzuar me votë mosbesimi. Duke folur për "Zërin e Amerikës", Kurti ndër synimet e para të qeverisë së ardhshme renditi Projektligjin

për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme dhe atë anti-mafia. "Duhet të fillojmë me projektligjin për mërgatën tonë, që duhet të ketë të drejtë të votojë në ambasada dhe konsullata. Gjithashtu, duhet ta fillojmë me Projektligjin për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe atë Antimafia. Duhet t'i kthejmë терминаlet doganore që u janë dhënë kompanive private në shtet", ka thënë Kurti, duke paralajmëruar edhe anulimin e disa vendimeve të qeverisë në largim.

Sa i përket trajtimit të pandemisë së Covid-19, Kurti tha se "synimi ynë do të jetë alokimi i fondeve, programimi i prioritetëve për shtresat shoqërore për vaksinim të rreth 60 për qind të popullsisë në këtë vit". Realizimi i kësaj, shtoi Kurti, do të bëhet në bashkëpunim me Bashkimin Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, QEMAJL MUSTAFA

PDK-ja duhet të reflektojë karshi rezultatit të zgjedhjeve

Kryetari i Degës i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan, Qemajl Mustafa, ka thënë se kjo parti duhet ta analizojë kujdesshëm rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se duhet të gjenden rrethanat që shkaktuan rezultatin e së dielës. Sipas tij, PDK-ja duhet të reflektojë. Mustafa ka bërë me dije se këtij subjekti politik i duhet një rirreshtim i mirëfilltë i vlerave brenda saj. Ai ka vlerësuar se PDK-ja për kohë të gjatë është udhëhequr nga njerëzit që kurrë nuk i kanë fituar komunitetet e tyre. Sipas tij, dikush tjetër mbledhte vota e dikush tjetër qeveriste dhe kishte pushtet të pakufishëm rreth liderit

ka treguar se në këtë subjekt ka pasur një ngatërrim të meritave, duke shtuar se PDK-së i duhet një rirreshtim i vlerave brenda strukturave partiake. “PDK-së i duhet një rirreshtim i mirëfilltë i vlerave brenda saj, që nga nëndegët e deri te kryesia në qendër. Neve na janë ngatërruar meritat shumëvjeçare të atyre që e nderuan partinë me shumë votë dhe me fitore brilante në fshatrat, në qytetet e në komunitetet e tyre, me vlerat civile të profesionistëve që tërë jetën u kanë bërë shërbim karrierave të tyre personale dhe nëpër procese zgjedhore janë katapultuar hiç më pak se në majë të partisë duke i goditur dhe marginalizuar rëndë ata të parët”, ka thënë

Mustafa, duke shtuar se këtë veprim PDK-ja e ka bërë keq nëpër disa procese zgjedhore. “Natyrshisht që jam plotësisht për ardhjet e reja në parti e sidomos për profesionistët e spikatur, por vetëm me ‘teknologji’ dhe në rrugë tjetër e jo kështu qysh ka ndodhur. PDK-ja për kohë të gjatë është udhëhequr nga njerëzit që kurrë nuk i kanë fituar komunitetet e tyre. Dikush tjetër argëtonte dhe i bënte fitoret e dikush tjetër qeveriste dhe kishte pushtet të pakufishëm rreth liderit. Disa nga ne aktivistët e mirë të saj kemi qenë të privuar nga e drejta për të përparuar në karrierë politike dhe brenda strukturës kemi mbetur ‘xhuxhë’ përkundër rezultateve të shumta të mira

EPOKA E RE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kryetari i Degës i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan, Qemajl Mustafa, ka bërë me dije se kjo parti duhet të reflektojë karshi rezultatit të zgjedhjeve të 14 shkurtit. Ai ka thënë se PDK-ja do t'i analizojë me kujdes të gjitha

rrethanat që kanë sjellë rezultatin e zgjedhjeve të fundit.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Mustafa ka treguar për ndryshimet që i duhen PDK-së pas zgjedhjeve të së dielës. “Patjetër që ne do të reflektojmë karshi këtij rezultati e sidomos karshi diferencës astronomike me

LV-në. Neve nuk na gëzon vendi i dytë para një LDK-je tashmë të rrënuar për arsyet e njohura. Ne do t'i analizojmë kujdesshëm, profesionalisht dhe me kulturë demokratike të gjitha rrethanat që e shkaktuan këtë trend gjithëkosovar dhe këtë rezultat për PDK-në, por kurrsesi me nguti e me eufori”, ka thënë Mustafa. Ai

që i kishim”, ka thënë Mustafa.

“Epoka e re”: Z. Mustafa, tani kemi rezultatin preliminar të zgjedhjeve të 14 shkurtit. Si e keni parë këtë rezultat?

Mustafa: Ne ishim të vetëdijshëm që ambienti i krijuar politik nuk është në favorin tonë. Dy liderët e PDK-së tashmë gjendeshin në Hagë. PDK-ja ka qeverisur për kohë të gjatë Kosovën dhe asaj i visheshin padrejtësisht të gjitha të metat e gjecjet në shoqërinë e saj, por pakkush i pranonte të arriturat e mëdha që kishin ndodhur që nga çlirimi e këndeje. Gjendja ekonomike e familjes mesatare në Kosovë nuk ishte e mirë. Por, përkundër kësaj, me projektin tonë zgjedhor i cili ishte i shkruar me kohë, ishte i lansuar me kohë dhe ishte i plotësisht inkurajues dhe i qartë për të gjithë, kemi pritur rezultat më të mirë. Së paku kemi pritur që ta ruajmë rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 e që nuk ndodhi, sepse orteku i votuesve shkoi në favor të LV-së duke i tkurrur të gjitha subjektet e tjera politike por, duhet theksuar, në këtë trend negativ për subjektet që e kishin qeverisur Kosovën deri më tani, më së paku u prek PDK-ja.

“Epoka e re”: Në këto zgjedhje PDK-ja është renditur parti e dytë, por me rezultat jo të mirë. Shifrat flasin për një rënie të kësaj partie krahasuar me zgjedhjet e vitit 2019. Cili është koment juaj për këtë rezultat?

Mustafa: Ky rezultat flet qartë për strukturën e qëndrueshme dhe shtrirjen e gjerë që ka PDK-ja sepse, përkundër rrethanave rënduese, ajo arriti të jetë immune dhe të mos ‘shembet’ sikurse i ndodhi LDK-së, por edhe AAK-së e Nismës.

“Epoka e re”: Ky rezultat ka nxitur disa reagime të brendshme partiake, duke kërkuar marrje të përgjegjësisë. A mendoni se është koha për ndonjë reformë në këtë parti?

Mustafa: Patjetër që ne do të reflektojmë karshi këtij rezultati e sidomos karshi diferencës astronomike me LV-në. Neve nuk na gëzon vendi i dytë para një LDK-je tashmë të rrënuar për arsyt fare të njohura. Ne do t'i analizojmë kujdesshëm, profesionalisht dhe me kulturë demokratike të gjitha rrethanat që shkaktuan këtë trend gjithëkosovar dhe këtë rezultat për PDK-në, por kursesi me nguti e me eufori.

“Epoka e re”: Cfarë duhet të ndryshojë kjo parti për t'u rikthyer në zgjedhjet e ardhshme?

Mustafa: Përgjigjen në këtë pyetje do ta japin rekomandimet pasi që të jetë analizuar mirë ky rezultat dhe konteksti historik e zgjedhor i Kosovës dhe i PDK-së. Megjithatë, unë jam i prirë ta them atë që unë e mendoj. PDK-së i duhet një rirreshtim i mirëfilltë i vlerave brenda saj, që nga nëndegët e deri te kryesia në qendër. Neve na janë ngatërruar meritat shumëvjeçare të atyre që e nderuan partinë me shumë votë dhe me fitore brilante në fshatrat, në qytetet e në komunat e tyre, me vlerat civile të profesionistëve që tërë jetën u kanë bërë shërbim karrierave të tyre personale dhe nëpër procese zgjedhore janë katapultuar hiç më pak se në majë të partisë duke i goditur dhe marginalizuar rëndë ata të parët. Këtë veprim PDK-ja e ka bërë keq nëpër disa procese zgjedhore. Natyrisht që jam plotësisht për ardhjet e reja në parti e sidomos për profesionistët e spikatur, por vetëm me “teknologji” dhe në rrugë tjetër e jo kështu qysh ka ndodhur. PDK-ja për kohë të gjatë është udhëhequr nga

njerëzit që kurrë nuk i kanë fituar komunat e tyre. Dikush tjetër mblidhte dhe i bënte fitoret e dikush tjetër qeveriste dhe kishte pushtet të pakufishëm rreth liderit. Disa nga ne aktivistët e mirë të saj kemi qenë të privuar nga e drejta për të përparuar në karrierë politike dhe brenda strukturës kemi mbetur “xhuxhë” përkundër rezultateve të shumta të mira që i kishim.

“Epoka e re”: Si duhet të sillet PDK-ja në opozitë gjatë këtij mandati?

Mustafa: PDK-ja duhet të sillet tepër kujdesshëm së pari ndaj shëndetit të saj. Asaj i duhet shqyrtim i thellë dhe diagnostifikim i saktë i gjendjes e pastaj terapia plotësisht efektive e cila e këndellë për kohë të shkurtër. Kreu i PDK-së duhet të dëgjojë kujdesshëm atë që e thonë degët e saj e sidomos mbi 1 000 nëndegët e saj për gjendjen e sotme. Opinione të mirë në terren janë matja më e mirë që mund ta marrin kryesia dhe Këshilli Drejtues në Prishtinë. Në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet e komunave PDK-ja duhet të jetë opozitë e angazhuar fort, duhet të jetë hulumtuese, e ditur dhe plotësisht korrekte.

Brenda 24 orëve dhjetë të vdekur nga Covidi në Kosovë

Të premten në Kosovë janë regjistruar edhe 340 raste të reja me Covid-19. Shifra bazohet në 2 715 mostra të testuara, thuhet në raportin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK). Sipas raportit janë shënuar edhe dhjetë viktima, duke e çuar numrin e përgjithshëm të viktimave në 1 568. Nga Covid-19 janë shëruar edhe 411 pacientë, ndërsa raste aktive janë 6 737



Gjilan 10 raste, Vushtrri 10 raste, Gjakovë 8 raste, Graçanicë 7 raste, Kaçanik 4 raste, Rahovec 4

raste, Shtime 4 raste, Viti 4 raste, Obiliq 3 raste, Klinë 2 raste, Malishevë 2 raste, Skenderaj 2

raste, Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog dhe Podujevë.

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 715 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 340 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar dhjetë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë tre raste (67,

80, 55 vjeç), Prizren dy raste (54, 46 vjeç), Rahovec dy raste (76, 52 vjeç), Ferizaj një rast (72 vjeç), Gjakovë një rast (81 vjeç) dhe Vushtrri një rast (58 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 65 690 raste nga 280 071 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 568 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 411 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 57 385 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 737. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 162 raste, Prizren 29 raste, Pejë 20 raste, Lipjan 18 raste, Mitrovicë 14 raste, Ferizaj 13 raste, Deçan 10 raste, Fushë-Kosovë 10 raste,

Kurti takohet me shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, bisedojnë rreth formimit të qeverisë së re

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër nga kjo lëvizje, Albin Kurti, ka pritur në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, të cilin e ka njoftuar me prioritetet e qeverisë së re. "Z. Szunyog e uroi kryetarin Kurti për fitoren në zgjedhje dhe shprehu dëshirën që institucionet e reja

të formohen pa ndonjë vonesë e të fillojë bashkëpunimi me qeverinë e re. Kryetari Kurti e falënderoi për urimin dhe e njoftoi atë me prioritetet e qeverisë së re ku, krahas punësimit dhe drejtësisë, në qendër është luftimi i krimit dhe korrupsionit, bashkë me Ligjin për Konfiskimin e Pasurisë", ka njoftuar Vetëvendosja.



Klinika e Gastroenterologjisë me shërbime të reja



PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Në Njësinë e Endoskopisë të Klinikës së Gastroenterologjisë me Hepatologji është kryer një intervenim jo vetëm i suksesshëm, por edhe për herë të parë në institucionet shëndetësore në Kosovë. Injektimi i parë i Toksinës Botulin është bërë te një i moshuar, i moshës 83-vjeçare, i cili kishte disa vjet që ankonte nga vështirësia në gëlltitje (disfagia), e cila vjen si pasojë të mungesës së kontraksioneve normale të trupit të ezofagut dhe mungesës së relaksimit të sfinkterit të poshtëm ezofageal. Për shkak të problemeve

shëndetësore kardiace dhe pulmonale, intervenimi operativ te pacienti ishte i pamundur. Te pacienti u injektua Toksina e Botulinit në katër vende me nga 20 njësi internacionale, brenda sfinkterit të poshtëm ezofageal, pa asnjë komplikim. Pacienti është në gjendje të mirë shëndetësore, gëlltitja ka filluar t'i stabilizohet, derisa është nën përcjelljen e stafit të klinikës. Metoda e injektimit brenda sfinkterik është e shpejtë, e lehtë dhe e sigurt për të sëmurin dhe deri tani është kryer vetëm në qendrat e specializuara jashtë vendit.

Osmani dekoron me medalje presidenciale Njësitin e Kërkim Shpëtimit të FSK-së

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, i ka ndarë dekoratën Medalje Presidenciale Ushtarake Njësitit të Kërkim Shpëtimit të FSK-së. "Për nder të 13-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, u.d. presidentja Vjosa Osmani e dekoroi Njësitin e Kërkim Shpëtimit të FSK-së për kontribut në fushën e mbrojtjes së Republikës së Kosovë dhe qytetarëve të saj. U.d. presidentja Osmani theksoi se kontributi i Njësitit të Kërkim Shpëtimit ndër vite ka qenë i jashtëzakonshëm. Puna e këtij njësi meriton çdo lëvdatë dhe me profesionalizmin e këtij njësi

krenohen të gjithë qytetarët e Republikës sonë", ka njoftuar Presidenca. Sipas këtij njoftimi, Osmani ka thënë se ky njësi i FSK-së ka dëshmuar se është i gatshëm t'i dalë në ndihmë çdo qytetari. "Në ditët tona më të vështira, ashtu si brenda kufijve, por edhe përtej, Njësi i Kërkim Shpëtimit i FSK-së ka dëshmuar se janë gjithmonë të gatshëm për t'u dalë në ndihmë qytetarëve tanë dhe jo vetëm", citohet të ketë thënë Osmani. Më tutje, Osmani e ka urrear Njësitin e Kërkim Shpëtimit të FSK-së për këtë arritje, duke shtuar se ky njësi do të jetë gjithmonë në nivel të detyrës.



AAK-ja vlerëson lart procesin zgjedhor



PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Kryesia dhe kryetarët e degëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në takimin e mbajtur të premtën, të cilin e ka drejtuar lideri i kësaj partie, Ramush Haradinaj, kanë vlerësuar lart procesin zgjedhor të 14 shkurtit, duke e cilësuar si një të arriturat më të mëdha të demokracisë në vend. Në këtë mbledhje është thënë se këto zgjedhje është thënë një avantazh Kosovës në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. "Në këtë takim

të strukturave më të larta të AAK-së u konstatua se Kosova tashmë duhet të shkojë tutje në kapërcimin e sfidave të saj që janë: liberalizimi i vizave, integrimet euroatlantike dhe marrëveshja për njohje të ndërsjellë midis Kosovës dhe Serbisë. Për t'u hapur rrugë këtyre objektivave, Kosova e ka të domosdoshëm krijimin e institucioneve si rezultat i zgjedhjeve të 14 shkurtit, duke përfshirë këtu krijimin sa më parë të Kuvendit, votimin e qeverisë dhe zgjedhjen e presidentit", ka njoftuar AAK-ja.

PAS ZGJEDHJEVE TË GJITHË ANALISTËT BËHEN TË MENÇUR... EDHE UNË



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Rezultatet e pritura dhe të papritura: Kanë mbetur të numërohen vetëm edhe votat e diasporës, votat me kusht dhe ato që kanë ardhur me postë dhe të dihet rezultati përfundimtar ku LV-ja del të jetë fituese absolute e zgjedhjeve e që edhe pak mund të rritet me këto vota. Sa i përket fituesit të zgjedhjeve, për këtë nuk ka pasur asnjë mëdyshje, vetëm përqindja e votave të fituara ka mundur të diskutohet. Edhe partitë e tjera garuese e kanë pasur shumë të qartë fituesin e zgjedhjeve ndonëse, për shkak të ngritjes së moralit të votuesve, kandidatëve dhe vetë partive, thuaja të gjitha janë deklaruar si fituese. Njerëzore dhe ngushëlluese! Tash, pas bërjes publike të votave të gjithë analistët, parashikuesit dhe fallxhorët janë bërë më të mençur, në mesin e tyre edhe unë! Po pse ndodhi kjo përmbetje aq e madhe? Të shkojmë me radhë:

1. Vetëvendosje! Disa ditë para zgjedhjeve e takova njërin nga krerët e LV-së që ka dalë dhe mundohet të mendojë dhe sillt si kryekoka, Albin Kurti, goftë edhe kur flenë. Realisht, emri i fillon me A, por nuk është Albini mirëpo, nëse e thirrni me emrin Albin, menjëherë përgjigjet. Në bisedë e sipër, isha me gruan dhe njihemi për faktin se kemi një lidhje miqësore: "bisht pas gardhit.." i thashë se LV-ja mund të fitojë 44-45 deputetë. E pranoi më shumë si provokim duke më thënë: "ja, po shihet se kush nuk na do të mirën...". Aty u binda se në kokën e LV-së, çdo shifër nën 61 deputetë është thuaja humbje. Në këtë kontekst, Albin Kurti në çdo paraqitje publike ka deklaruar se na duhen 61 vota dhe se këto zgjedhje janë referendum në kohën kur në Kosovë nuk lejohet as referendum për tredhje të qenve! Albini ka përdorur sugjestionin për t'i bindur anëtarët e LV-së, kandidatët, votuesit, opinionin sikur që ka dekurajuar partitë e tjera garuese. Albin Kurti në këto gara e ka përdorur matematikën si mjet për të fituar aq shumë vota. E ka bombarduar opinionin me shifra të larta, e bëri një "shock" listë në të cilën i futi të gjitha profilet, të gjitha moshat, të gjitha profesionet, të gjitha orientimet politike dhe jopolitike, të vuajtur, të stërvuajtur, hedonista, të pastër, me aktakuza, hoxhallarë dhe enveristë të Maqellarës, ekzibicionistë dhe delikuentë

seksualë, artistë dhe sportistë, proletarë, përkrahës të Tanzanisë dhe mercenarë të Shqipërisë. Rugovistëve të përбетuar ua mori Ibrahim Rugovën dhe vazhdoi me goditje duke e marrë, thuaja krejtësisht diasporën. Hasan Prishtinën e bëri Agim Bahtir, Vjosën, Shotë Galicë virtuale dhe në disa raste e përmendi edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si dhe Korin e Burrave të Jakovës. Me t'u kthyer nga varri i Ibrahim Rugovës, mori në thua te varri i Adem Demaçit dhe tha se: "Adem Demaçi është Mendela i shqiptarëve ... sikur që e thonë të gjithë për Bacën Adem Demaçi, sa për të larë duart, si Pont Pilati..". Ka qenë përtej se të thuhet fer me Vjosa Osmanin, i tha presidente dhe do ta bëjë presidente ndërkaq, ua bëri votat kandidatëve nga Lista Vjosa e që në rrethanat ekzistuese do të ishte mision i pamundur që ta kalonin pragun zgjedhor. Mënyra se si ka luftuar Kurti për të ardhur në pushtet e dëshmon thënien e Çerçillit për: "shumë djersë dhe gjak..". Struktura organizative e LV-së është më e sofistikuar dhe më e organizuar se struktura e AKI-së, kurse bindja ndaj liderit është e barabartë me bindjen e një besimtarit budist ndaj Dalaj Lamës dhe Budës, Gotamës. Mund edhe mos të pajtoheni me Albin Kurtin dhe LV-në, mirëpo duhet ta respektoni votën që e kanë marrë dhe nuk duhet të pengohet me asgjë në realizimin e programeve dhe premtimeve. Albin Kurti dhe LV-ja nuk rrezikohen nga opozita e ardhshme mirëpo, proceset, nëse nuk menaxhohen mirë nga Albin Kurti dhe LV-ja do ta krijojnë një opozitë të fuqishme. Varësisht prej zhvillimit të bisedimeve me Serbinë dhe rimëkëmbjes ekonomike, qeveria Kurti do ta përfundojë mandatin ose, mund të marrë në thua pas 12 muajve. Uroj që të punojë mirë dhe të përkrahët nga të gjithë. E kam përkrahur LV-në në kohët më të vështira, ka kohë që i kemi ndarë rrugët por, në asnjë mënyrë, nuk do t'i gëzohem dështimit të saj. Krejt në fund, kur të studiohet mënyra se si ka ardhur në pushtet Albin Kurti dhe LV-ja, Princi - Sundimtari i Makiavellit do të mbetet literaturë për fëmijë të enteve parashkollore!

2. Partia Demokratike e Kosovës: Në bisedë me disa miq që i kam aty, kam thënë se, nëse i fitojnë 20 deputetë, mund të llogariten se janë fitues apo në "kali të bardhë". Më thoshin se janë më mirë se në zgjedhjet e fundit dhe se do t'i fitojnë së paku 27 deputetë. PDK-në e ka shpëtuar të pësojë më shumë vetëm një angazhim i jashtëzakonshëm në terren dhe një grup deputetësh që e kanë çkyer prapancën për të siguruar një mandat dhe, në këtë mënyrë, kanë siguruar vota edhe për partinë. Arrestimi i udhëheqësve, aktualë dhe shpirtërorë të PDK-së

e ka dobësuar këtë parti mirëpo, gabimin më të madh e kanë bërë kur e rrezuan qeverinë Kurti, në kohë pandemie. Unë në atë kohë pata reaguar në media duke kërkuar që PDK-ja mos ta votojë mocionin për rrëzim të qeverisë. Pastaj, çfarë kuptimi ka rëzimi i qeverisë dhe ju përsëri të mbeten në opozitë. Tutje, në emër të partneritetit me amerikanë, Grenellin dhe Trampin e rrezuan qeverinë, kurse pikërisht amerikanët i arrestuan dhe i dërguan në Hagë. PDK-ja një kohë ua ka parë hairin disa mujsharëve dhe banditëve, kurse më vonë ua kanë parë sherrin dhe do t'ua shohin derisa të lirohen nga ta. Nuk ka aferë pas lufte ku nuk janë përmendur këta mujsharë dhe PDK-ja shumë mirë ka kaluar. Kadri Veseli kishte vullnet të bënte reforma brenda PDK-së, ta bëjë vetingun, ta kërkojë formimin e një Gjykate Ndërkombëtare për Krime të kalonësve në Serbia në Kosovë, por u pengua nga vetë partia që e drejtonte. PDK-ja si opozitë nuk duhet të hezitojë në formimin e institucioneve që kanë dalë nga zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, prandaj duhet ta votojë çdo propozim të pozitës dhe, pas kësaj, të kalojë në opozitë!

3. Lidhja Demokratike e Kosovës: As në imagjinatën më improvizuese nuk kam paramenduar se LDK-ja do të përgjysmohet në këto zgjedhje, prandaj edhe u rritë aq shumë LV-ja. LDK-ja ka qenë subjekti që ka pësuar më së shumti nga ndarjet e brendshme. Në fillim ishte Daci që e përçau LDK-në duke e formuar një subjekt politik, të përafërt me LDK-në. Pastaj, LDK-në e ka dëmtuar shumë Fatmir Sejdiu. Pas kësaj, LDK-në e dëmtoi shumë Vjosa Osmani, të cilën e rriti dhe e forcoi. Vjosa Osmani jo që nuk formoi subjekt të vetin politik, por iu bashkua partisë e cila me të gjitha mjetet ka punuar për ta dobësuar LDK-në e ajo është LV-ja. Duke ditur se me AAK-në dhe PDK-në nuk mund të tregojë muskuj, Albin Kurti u orientua kah LDK-ja dhe plotësisht ia arriti qëllimit. Mendoj se pa asnjë arsye sulmohen Isa Mustafa dhe Avdullah Hoti sepse, Isa Mustafa arriti ta rrisë LDK-në pas ndarjes sikur që u tregua bashkëpunues me LV-në ndonëse kjo e sulmoi me të gjitha mjetet e mundshme, e fyeu personalisht dhe familjarisht dhe, së fundi, ia montoi një bombë shpërthyes, Vjosa Osmanin. Kur Isa Mustafa i fitonte kundërshtarët, e lavdëronin se me një këmbë po i mund kundërshtarët. Po të njëjtët tani duan ta kryqëzojnë, pa arsye. Avdullah Hoti bëri një fushatë normale dhe pati sjellje normale. Ai nuk kishte shtab zgjedhor dhe fitohet përshtypja se i kanë vënë shumë ndërskamca disa nga bashkëpartiakët. Jo që nuk e ndihmuar, por e sabotuan. LDK-ja as që duhet të mendojë për

Vjosa Osmanin, por duhet ta kujtojë si një ëndërr e keqe, si një ankh dhe si një makth që, rrinte në parti dhe ishte më shumë e LV-së se vetë Albin Kurti. LDK-ja duhet ta zgjedhë një kryetar që nuk ka hipoteka nga e kaluara, që nuk ka pasur pushtet në të kaluarën, por që ka njohuri politike dhe vullnet për rimëkëmbje të LDK-së. Nëse i ndërmer këto veprime LDK-ja do të forcohet, në të kundërtën do ta pësojë si Partia e Prosperitetit Demokratik në Maqedoni. LDK-ja ka potencial, mundësi dhe dije, nëse e bën përzgjedhjen e duhur, të bëjë reforma dhe të rikthehet. LDK-ja është e rëndësishme për Kosovën në këtë fazë dhe për proceset që e presin në të ardhmen Kosovën. Aktualisht LDK-së, Rugovën ia mori Albin Kurti dhe LDK-ja duhet të krijojë një identitet tjetër. LDK-ja është parti me orientim djathtist dhe, si e tillë, i duhet Kosovës. Nuk janë fajtorë për këtë humbje as Isa Mustafa, as Avdullah Hoti, as Agim Veliu dhe të tjerët, por pushteti i gjatë i ka konsumuar dhe ndarjet e shpeshta dhe të mëdha e kanë dëmtuar shumë. Ndërkaq, LV-ja përmes Vjosa Osmanit e ka kryqëzuar në zgjedhjet e fundit. Shiheni kush e sulmon LDK-në, një delikuent seksual që ka blerë shërbime seksuale, pa e marrë kuponin fiskal, duke i ikur tatimit. Vjosa Osmanit nuk i ha palla më për LDK-në për faktin se bëhet presidente me mandat pesëvjeçar. Vetëm nëse ka zhvillime të paparashikueshme dhe nuk i bën numrat për presidente, Vjosa Osmani do të bëjë përpjekje t'i kthehet LDK-së, duke u liruar nga kundërshtarët politikë brenda partisë dhe duke e bërë LDK-në, pjesë të LV-së.

4. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: Ka mbetur në komizat e së pritshmes. Ka bërë llogari të gabuar se do të jetë përcaktues i formimit të institucioneve të Kosovës duke e kushtëzuar me postin e presidentit. Këto matematika ua ka prishur Albin Kurti dhe LV-ja, me një përmbysje të madhe, thjesht të paimagjinueshme për një sistem proporcional. AAK-ja duhet t'i bashkohet opozitës dhe të ndërtojë një bllok opozitar konstruktiv. Për fillim duhet ta votojë zgjedhjen e qeverisë, zgjedhjen e presidentes dhe pastaj ta luajë rolin opozitar.

5. Lista Srpska: Është parti e Serbisë në Kosovë. Është kundër Kosovës dhe gjithnjë deklarohet se shteti i tyre është Serbia, kurse kryetar është Aleksandër Vuçiq. Këtë e thotë haptazi dhe nuk lë asnjë dyshim në këtë drejtim. E ka përkrahjen e ndërkombëtarëve. Para dy muajve pata shkruar se Lista Serbe do të forcojë Iniciativa në Veri të Kosovës për ta përkrahur mercenaren Adriana Hoxhiq që vazhdimisht ka qenë instrument i Listës Serbe apo qarqeve

shoviniste serbe në Kosovë dhe, në Graçanicë, Gazmend Salijeviqin që ka qenë po në të njëjtat valë. LS-ja edhe ia arriti qëllimit dhe me këta deputetë të kontrabanduar, thuaja barazohet me deputetë me LDK-në. Çfarë krimi elektoral!

Si do të shkojë formimi i institucioneve: Albin Kurti deklaroi se nuk do të bëjë asnjë koalicion me partitë shqiptare sepse paska bërë një koalicion me Vjosa Osmanin. Nuk do të bëjë as koalicion me Listën Serbe që nënkupton se do ta kemi një qeveri të pakicës. LV-ja, me disa deputetë të pakicave joserbe. Në anën tjetër kërkon votën nga opozita të cilën botërisht e poshtëron. Në një politikë inatçore, opozita do t'i përgjigjej me një injorim të plotë, kurse mendoj se opozita duhet ta bëjë të kundërtën, ta votojë propozimin për qeveri dhe për president. Ky do të ishte sinjal se opozita e ka përmendur vullnetin për t'u reformuar dhe do t'i ndihmonte opozitës qysh në zgjedhjet lokale. Ndërkombëtarët janë përcaktuar që institucionet të formohen nga partitë fituese, LV-ja, Lista Serbe dhe pakicat joserbe. Ashtu edhe do të bëhet dhe me këtë përcaktim të ndërkombëtarëve përjashtohen zgjedhjet e reja. Albin Kurti, për shkak të komplikimeve të mundshme kushtetuese, përkohësisht mund ta vendosë në postin e kryeministrit, klonin e tij, Arben Vitinë i cili, pastaj, në shtator, do të lëvizte prapancën nga posti i kryeministrit, për t'ia liruar Albin Kurtit. Mirëpo, përfundimisht Vjosa Osmani, në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si person unifikues për faktin se nuk është a pavarur politikisht, është në konflikt të hapur me LDK-në sepse ka punuar për shkatërrimin e kësaj partie dhe se ka shfaqur urrejtje të madhe dhe hakmarrëse ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së dhe PDK-së. AAK-ja e ka kandidatën për president. Vetëm një presion ndërkombëtar mund ta bëjë Vjosa Osmanin presidente apo edhe një thyerje tjetër brenda LDK-së. Vjosa Osmani nuk mund të bëhet presidente pa votat e PDK-së, LDK-së dhe AAK-së dhe, së paku, 14 deputetëve të Aleksandër Vuçiqit në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, në anën tjetër, nëse duam ta forcojmë demokracinë duhet ta respektojmë vullnetin e votuesve dhe, në këtë rast, 50 për qind e votuesve kanë votuar për LV-në, prandaj do të ishte krejtësisht e pamoralshme dhe kundër interesave të Kosovës që shpërfillet apo shantazhohet ky vullnet. Po këto zgjedhje kanë prodhuar dy efekte shumë pozitive, e para mikes time Kimete Berishës i është plotësuar dëshira që Albin Kurti u bë Xhingis Kani i Kosovës e për të cilin qëllim ka luftuar me të gjithë dhe, e dyta, më në fund u krijuan mundësitë që Besnik Bislim ta bëjë një sy gjumë!

Rindërtimi i një besimi të humbur

Partitë të nxjerrin mësim nga humbja politike, por humbja nuk është gjithmonë humbje, ajo në vetvete ngërthen një çast reflektimi dhe nxit forcën për ringritje, forcën për ta rishikuar vetveten, forcën për t'u çliruar nga egocentrizmi, forcën për të mos pranuar për të qenë të parët pa meritë por, për më shumë, ngërthejnë në vete forcën për të punuar, para së gjithash, jo për veten, por për qytetarin



Ismet HAJRULLAHU

Përse në partitë politike nuk ka rotacione elitash dhe pse i rezistojnë me çdo kusht reformimit dhe transparencës ndaj anëtarësisë dhe strukturave bazë, që nga nëndega e deri në qendër?

Nga kush apo nga çfarë po trembën, kur të gjithë, e sidomos vetë ata, e dinë se një reformë e brendshme do të nxiste dhe prodhonte një zhvillim demokratik brenda partisë? Pa dyshim që reformat marrin kohë dhe, për më shumë, kërkojnë vizion e strategji se si të arrihet rikrijimi i nevojshëm. Katërmbëdhjetë shkurti i dha

shumicës së partive një leksion të rëndësishëm për reformat e domosdoshme që duhen ndërmarrë sa ma parë, me qëllim që t'u përshtaten nevojave të qytetarëve, duke dëgjuar më shumë e, natyrisht, duke urdhëruar më pak. Reformat partiake të cilat bëhen duke përcjellë me vëmendje lëvizjet e elektoratit, janë të shëndosha dhe prodhojnë sjellje institucionale dhe vendimmarrje të shtrirë mbi një bazë të gjerë përfaqësuese dhe konsultuese, duke filluar nga niveli i nëndegëve, degëve dhe qendrës.

Mungesa për një kohë të gjatë e reformave, në anën tjetër, bën që partitë politike të mos përputhen në kontekst të organizimit me partitë simotra në shtetet e Bashkimit Evropian, si dhe rezistenca ndaj reformës nga poshtë-lart dhe nga të asaj lart-poshtë, dobëson strukturat qendrore të partive, gjë e cila reflektohet më pas natyrshëm edhe në të gjitha nivelet e

strukturave të tjera partiake.

Por, mbi të gjitha, mungesa e reformave të thella, eventualisht shkakton edhe humbje të thella si këto të fundit. Pavarësisht prej organizimit të zgjedhjeve të brendshme partiake, fiktiviteti i cili i përcjellë zakonisht këto procese, rezultojnë më pas në zgjedhje fiktive dhe vendimmarrje jotransparente përpara anëtarësisë së partisë dhe, përfundimisht, në një kequdhëheqje nga kryetarët të cilët, si mbulesë për vendimet e gabuara, përdorin kryesitë dhe shpesh edhe këshillat drejtuese. Kjo qasje dhe mungesë e llogaridhënies cenon demokracinë e brendshme të partive në të gjitha strukturat, duke shkaktuar mungesë të transparencës, dhe një konfuzion, i cili nga partia natyrisht përçohet edhe në elektorat. Ndërkaq, partitë të cilat udhëhiqen nga kjo logjikë e vjetërsuar, e pothuajse gati komuniste e organizimeve të brendshme, eventualisht për

shkak të pushtetit absolut të brendshëm, perceptohen, apo për më keq shndërrohen në parti me udhëheqje thuasje "diktatoriale".

Por ndërkohë që ka një pushtet absolut të individëve të caktuar përbrenda partive, kjo përcillet me anashkalim dhe dobësim të thellë të strukturave partiake, e që pa dyshim ndikon negativisht dhe dobëson edhe cilësinë e vet partisë. Kështu, dështimet e jashtme të partive vijnë thuasje gjithmonë si rezultat i dështimeve të brendshme të tyre.

Prandaj edhe mbetet jetike dhe emergjente nevoja për reformimin e partive politike, e sidomos reformimi tërësor i statuteve dhe përputhshmërisë së tyre me parimet e një organizimi demokratik, de jure, por edhe de facto.

Ndërkohë që, po aq e rëndësishme mbetet edhe llogaridhënia dhe transparenca financiare e brendshme dhe ndarja proporcionale e financave sipas nevojave reale të strukturave. Ndërtimi dhe kultivimi i një qasjeje të tillë, pashmangshëm do ta ndryshonte edhe perceptimin e elektoratit sa i përket vendimmarrjes, por edhe punës së partive në terren.

Ndryshimi i perceptimit, ndërkaq, është hapi tjetër drejt fuqizimit dhe rindërtimit të besimit të humbur me një

elektorat të dëshpëruar dhe tradhtuar.

Por qytetari di edhe të falë, mirëpo vetëm atëherë kur partitë nuk sillen si monarkë por, përkundrazi, bëhen një me të. Siç është thënë edhe nga Konrad Adenauer, pa dyshim se të gjitha mendimet dhe i tërë veprimi i njeriut shpeshherë varet nga koha dhe u nënshtrohet ndryshimeve. Por, nëse formojmë parti politike, e cila u përmbahet kërkesave të cilat i dikton koha, atëherë partia e tillë do të jetë sterile dhe jetëshkurtër. Veçanërisht partitë ose, thënë më mirë, sidomos partitë politike në qoftë se dëshirojnë të mbijetojnë, duhet të ndërtohen në thellësi.

Ato duhet të bazohen në vlera të përjetshme. Me këtë kuptohet se, përveç ndjekjes së trendëve politike, të cilat duhet të inkorporohen në vazhdimësi në kuadër të programeve dhe ofertave politike, qëndrueshmëria e një partie sigurohet nga qëndrueshmëria e vlerave që ajo ka përfaqësuar e që përfaqëson.

Nëse me programe mund të eksperimentohet deri-diku, ideologjia e një partie mbetet bërthama e saj, e cila nuk mund të tolerojë në afatgjatë, bashkim të bindjeve të kundërta nga vlerat të cilat e kanë bashkuar atë në radhë të parë. Çdo devijim nga vlerat është vetëm oportunitizëm politik, i cili nuk garanton qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të një funksionimi të shëndoshë të partive politike.

E si gënjeshtër, ashtu edhe oportunitizmi politik, që të dyja i kanë këmbët e shkurtra! Prandaj është me rëndësi që partitë të nxjerrin mësim nga humbja politike.

Por humbja nuk është gjithmonë humbje, ajo në vetvete ngërthen një moment reflektimi dhe nxit forcën për ringritje, forcën për ta rishikuar vetveten, forcën për t'u çliruar nga egocentrizmi, forcën për të mos pranuar për të qenë të parët pa meritë por, për më shumë, ngërthejnë në vete forcën për të punuar, para së gjithash, jo për veten, por për qytetarin.



Ministri Nitaj nënshkruan marrëveshje mirëkuptimi me "Trainkos"-in dhe "Unitet"-in

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi për subvencionimin e dy ndërmarrjeve publike, me "Trainkos"-in dhe "Unitet"-in.

Kryeshefat e ndërmarrjeve,

Gelor Shala i "Trainkos"-it dhe Gazmend Morina i "Unitet"-it, e kanë njoftuar ministrin Nitaj për afarizmin e ndërmarrjeve të tyre dhe kanë shprehur mirënjohjen e tyre për mbështetjen e dhënë nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

Kryeshefi i Kompanisë së

"Pastrimit" nga Mitrovica, Gazmend Morina, po ashtu e ka njoftuar ministrin Nitaj për vështirësitë që kanë punëtorët për kryerjen e punëve si pasojë e teknikës së vjetërsuar me të cilën punojnë dhe borxhet që ka ndërmarrja ndaj ATK-së të trashëguara ndër vite.



Nga skema e ndihmës sociale përfituan 25 679 familje

Sipas rezultateve të dala nga publikimi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), rezultojnë se gjatë tremujorit të katërt (TM4) 2020 nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 25 679 familje, me gjithsej 103 189 anëtarë dhe nga skema për mbështetje materiale, familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 2 436 familje

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e mirëqenies sociale" për TM4 2020. Ky publikim ofron të dhëna për numrin e përfituesve nga skema e ndihmës sociale, skema e pensioneve bazë të moshës, të pensioneve kontributpaguese të moshës, skemën e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara, skemën e pensioneve për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, skemën për

mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, skemën për pensionet familjare, skemën për pensionet invalidore, skemën e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës, skemën e pensioneve të "Trepçës", skemën e pensioneve për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, skemën e kompensimeve për personat e verbër, të dhëna për numrin e fëmijëve të braktisur etj. Sipas rezultateve të dala nga publikimi i Agjencisë së

Statistikave të Kosovës (ASK), rezultojnë se gjatë tremujorit të katërt (TM4) 2020 nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 25 679 familje, me gjithsej 103 189 anëtarë dhe nga skema për mbështetje materiale, familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 2 436 familje. Ndërkaq nga skemat pensionale rezultojnë se nga skema e pensioneve bazë të moshës ishin 142 280 përfitues; nga skema e pensioneve kontributpaguese të moshës ishin 49 451 përfitues; nga skema për pensionet familjare




ishin 3 712 përfitues; nga skema për pensionet invalidore ishin 81 përfitues; nga skema për pensionet e "Trepçës", ishin 2 341 përfitues; nga skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës ishin 1 166 përfitues; nga skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës ishin 583 përfitues; nga skema e kompensimeve për personat e verbër ishin 1 848 përfitues; nga

skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara ishin 19 266 përfitues; nga skema për pensionet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë ishin 2 797 përfitues; nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës ishin 13 550 përfitues; dhe nga skema për veteranët e luftës ishin 38216 përfitues. Sipas këtij njoftimi, gjatë TM4 2020 janë braktisur pesë fëmijë.

FMN-ja vlerëson masat e ndërmarra nga BQK-ja për tejkalimin e krizës nga pandemia

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHKURT - Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka njohur angazhimin dhe qeverisjen efektive të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Sipas vlerësimeve të FMN-së, sektori bankar ka arritur ta përballojë mirë situatën e krijuar si rezultat i masave të ndërmarra për përballimin e pandemisë. "Bankat e kanë përballuar mirë recesionin deri më tani, duke u mbështetur në nivelet e larta të likuiditetit dhe të kapitalit të para pandemisë Covid-19, të cilat kanë kontribuar për ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. FMN, gjithashtu, ka njohur edhe masat e ndërmarra nga ana e BQK-së për ristrukturimin e kredive, ndërsa në dhjetor të vitit 2020 të gjitha bankave iu kërkua t'i zbatojnë kërkesat rregullatore që kanë qenë në fuqi para pandemisë Covid-19. Të dhënat paraprake



sinjalizojnë një portofol të shëndetshëm të kredive, me mundësi për një rritje të lehtë të kredive joperformuese në muajt në vijim", është thënë në njoftimin e BQK-së. Më tutje, theksohet se në fund

të vitit 2020 asetet e sektorit bankar shënuan rritje prej më shumë se 12 për qind. "Niveli i kredive joperformuese ishte 2.63 për qind, raporti i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione

ishte 143.27 për qind, përderisa raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 16.7 për qind", thuhet në njoftimin e BQK-së. Po në këtë njoftim është theksuar se reformat e zbatuara nga Banka

Qendrore e Republikës së Kosovës në vitet e kaluara, të cilat u fokusuan në forcimin e sigurisë financiare dhe kornizës mbikëqyrëse bankare, ndihmuan në zbutjen e presioneve nga pandemia. Sipas BQK-së, shumë nga reformat e zbatuara janë dizajnuar me mbështetjen e FMN-së. "BQK-ja mbetet e përkushtuar ta vazhdojë forcimin e kapaciteteve dhe sistemeve të saj, përfshirë edhe zbatimin e rekomandimeve që kanë dalë nga raporti i Rishikimit të Stabilitetit të Sistemit Financiar. Së këndejmi, drejtorët ekzekutivë të FMN-së rekomanduan autoritetet që ta monitorojnë nga afër cilësinë e aseteve bankare, të sigurojnë transparencë në pasqyrimin e humbjeve pasi të hiqet toleranca rregullatore dhe ta forcojnë më tej kornizën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", është thënë në njoftimin e BQK-së.

Këtë vit nuk do të mbahet manifestimi i "Javës së Minatorëve"

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Sindikata e Pavarur e Minatorëve të "Trepçës" ka bërë me dije se për shkak të situatës aktuale me pandeminë Covid-19, këtë vit nuk do të mbahet manifestimi qendrori i "Javës së Minatorëve" në Stan Terg. Lajmin e ka bërë me dije për

gazetën "Epoka e re" anëtari i bordit i "Trepçës", Shyqyri Sadiku, i cili ka thënë se do ta respektojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për respektimin e masave anti-Covid. Referuar agjendës zyrtare të cilën e kanë vendosur Sadiku, ka thënë menaxhmenti i "Trepçës", përfaqësuesit e

sindikates, si dhe një numër i punëtorëve do të bëjnë vizitë të pllaka e minatorëve grevistë të vitit 1989. "Ne do të bëjmë vizitë të pllaka e minatorëve grevistë të vitit 1989, te varrezat e dëshmorëve të kombit në Prekaz, si dhe të varrezat e kombit në Shipol", ka thënë Sadiku.



Task-forca për arsim kërkon që edhe gjimnazi në Malishevë t'i kthehet mësim sipas planit 'A'

MALISHEVË, 19 SHKURT (ER) - Task-forca komunale për menaxhimin e situatës pandemike në shkollat e Komunës së Malishevës, e drejtuar nga nënkryetari Hajdin Berisha, pas vlerësimit të situatës me Covid-19 në shkollat e Malishevës, në mënyrë të veçantë për gjendjen në gjimnaz, e vetmja që punon sipas planit 'B' u kërkua që mësimi edhe në këtë shkollë të zhvillohet sipas planit 'A'.

Drejtori i Arsimit, Blerim Thaçi, ka kërkuar që mësimi në Gjimnazin "Hamdi Berisha" t'i kthehet normalitetit, pasi është e vetmja shkollë që punon sipas planit 'B'. "Gjendja është e mirë dhe nuk ka probleme sa i përket situatës me Covid-19, ndërsa nxënësit janë duke humbur shumë mësim dhe rrjedhimisht dëmet janë të pariparueshme. Kërkoj që mësimi të zhvillohet me

klasë të kompletuara, duke i zbatuar masat anti-Covid, sipas master planit të ministrisë", ka thënë drejtori Thaçi. Pas shqyrtimit të situatës dhe të kërkesës së Drejtorisë së Arsimit, Task-forca, unanimisht është pajtuar që të kërkohej nga institucionet qendrore përgjegjëse, që t'i lejohet edhe Gjimnazit "Hamdi Berisha" të vazhdojë me mësimin e rregullt sipas planit 'A'.



Bie numri i rasteve me Covid në Gjilan



GJILAN, 19 SHKURT (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin e radhës për vlerësimin e situatës së pandemisë në dy ditët e fundit. Nënkryetari Ismajli ka bërë me dije se aktualisht numri

i rasteve aktive në Gjilan është 95. Krahasuar me javët e fundit, numri i rasteve të infeksionit është më i ulët, por Ismajli ka thënë se kjo nuk lejon komoditet, duke apeluar qytetarët dhe bizneset që japin shërbime, që t'u përmbahen masave kundër përhapjes së virusit, siç janë maska,

distanca dhe higjiena personale. Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 1 1081 mostra, 3 592 kanë rezultuar pozitivë, 3 387 janë shëruar, 110 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 95 raste janë aktive, të hospitalizuara me Covid janë 16 persona.

Kryetari Rugova falënderon KFOR-in për bashkëpunim

ISTOG, 19 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, ka pritur të premten në takim kolonel Francesco Maioriello, komandant i Komandës Regjionale Perëndim të KFOR-it dhe i kontingjentit italian në Kosovë, me të cilin ka bashkëbiseduar për rrjedhën e punëve në Komunën e Istogut si dhe mundësinë e bashkëpunimit me KFOR-in italian. Kryetari Rugova ka

falënderuar kolonelin Maioriello për vizitën dhe ka falënderuar për bashkëpunimin e mirë si dhe për krahejen e vazhdueshme me projekte që Komuna e Istogut ka nga KFOR-i italian, duke shpresuar që ky bashkëpunim i mirë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Koloneli Francesco Maioriello ka thënë se ka ardhur për vizitë në këtë komunë që të njoftohet nga afër me kryetarin Rugova.



Ministria e Ekonomisë do ta ndihmojë Junikun në projekte infrastrukturore

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka pritur të premten në takim kryetarin e Komunës së Junikut, Agron Kuçi, me të cilin kanë diskutuar për punët që po bëhen në këtë komunë, si dhe kanë nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi. Nitaj ka përgëzuar kryetarin Kuçi për punën që po bën për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Junikut dhe ka ofruar mbështetjen e tij dhe të ministrisë që drejton për realizimin e projekteve që janë në funksion të mirëqenies së qytetarëve të kësaj komune. "Sot nënshkruam marrëveshje bashkëpunimi për

bashkëfinancimin e projektit për rregullimin e shtratit të lumit Erenik si dhe marrëveshje për bashkëfinancim në rregullimin e ujësjellësit në lagjen Agim Ramadani në Junik", ka deklaruar Nitaj. Ndërsa kryetari Kuçi ka falënderuar ministrin e MEA-së, Nitaj, për përkrahjen që po i ofron në zhvillimin dhe avancimin e projekteve që kanë impakt pozitiv në jetën e qytetarëve të kësaj komune. Këto dy projekte do të realizohen në bashkëfinancim nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe e Komunës së Junikut, ku MEA-ja do të financojë në vlerë 180.000.00 euro.



Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377



AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



ISBN 978-9951-780-10-0

9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ramadani: Krenar që isha pjesë e kësaj historie të suksesshme

Selektori Taip Ramadani është ndarë me Përfaqësuesen e Kosovës pas pesë vjetësh. Ai ka thënë se ndihet krenar që ishte pjesë e kësaj historie të suksesshme me “dardanët” e hendbollit. “Mbetëm përgjithmonë mirënjohës dhe krenar që e pata rastin të jem pjesë e vogël e historisë të kësaj përfaqësuese. Ka qenë detyra më sfiduese që kam ndërmarrë ndonjëherë, por edhe më shpërblyese. Sot jam jashtëzakonisht krenar që mund ta quaj veten ‘Dardan’. Ekipit i uroj suksese të shumta në sfidat e ardhshme. Gjithmonë do ta ketë përkrahjen time”, ka thënë Ramadani



Ndodhi, por kjo veç na forcoi vendosmërinë si ekip dhe na bëri ta kuptojmë realitetin e gjendjes. U zhgënjyem shumë, ama nuk e ulëm kokën. Vazhduam pak nga pak, filluam ta gjejmë ritmin tonë. Qëllimi i parë ishte të ngrehemi nga grupi i shteteve në zhvillim. Me fitore kundër Luksemburgut dhe Qipros, ndër shtete të tjera, e arritëm këtë në Bullgari më 2017. Pastaj në kampanjën kualifikuese të ‘Euro 2020’, arritëm të klasifikohemi direkt në fazën e dytë të Kampionatit Evropian”, ka thënë Ramadani. “Fitorja e parë në Kampionatin Evropian na erdhi kundër Izraelit në Prishtinë. Në Nynberg, para 10 mijë shikuesve, djemtë arritën për një pjesë të plotë të luajnë baras me Gjermaninë (12:12).

Edhe pse në fund e humbëm lojën, kjo ishte testament i aftësisë së ekipit. Më 12 qershor 2019, në një atmosferë të flaktë hendbolli, në Prishtinë arritëm ta sfidojmë superfuqinë e hendbollit, Poloninë. Fitoren e kishim në duar, por sekondën e fundit të lojës, Polonia e barazoi rezultatit. Në janar 2020, në kualifikimet për kampionatin botëror, barazuam me Italinë dhe fituam kundër Gjeorgjisë, duke e siguruar vendin e dytë në grup, mbas Rumanisë. Ekipi vazhdon të ngrehet në nivel të lartë ndërkombëtar”, ka shtuar ai. Taip Ramadani ndihet krenar që ka qenë pjesë e kësaj historie të Përfaqësueses së Kosovës. “Mbetëm përgjithmonë mirënjohës dhe krenar që e pata rastin të jem një pjesë e vogël e

historisë të kësaj përfaqësuese. Ka qenë detyra më sfiduese që kam ndërmarrë ndonjëherë, por edhe më shpërblyese. Sot jam jashtëzakonisht krenar që mund ta quaj veten ‘Dardan’. Ekipit i uroj suksese të shumta në sfidat e ardhshme. Gjithmonë do ta ketë përkrahjen time”, ka thënë Ramadani, i cili në fund ka falënderuar edhe familjen për mirëkuptimin dhe durimin që kishin ndaj tij përgjatë këtyre viteve.

Ndërsa kryetari i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, e ka falënderuar trajnerin Taip Ramadani për punën dhe kontributin e madh që ka dhënë për hendbollin e Kosovës. Njëshi i FHK-së e ka quajtur Ramadanin si njërin nga selektorët më të suksesshëm të Kosovës. “Në emër të Bordit të Federatës së Hendbollit të Kosovës e falënderoj selektorin e deritashëm, Taip Ramadani, për kontributin shumëvjeçar dhe për sukseset të cilat i ka arritur së bashku me ekipin e tij. Mund të konstatohet se Taip Ramadani ka qenë një nga selektorët më profesionist dhe më të suksesshëm të hendbollit të Kosovës. Shpresoj që në një të ardhme të afërt të kemi mundësi për një takim lamtumirës me Taipin”, ka thënë Ramadani.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 19 SHKURT - Taip Ramadani, pas një periudhe rreth pesëvjeçare, është larguar nga Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll. Trajneri në fjalë e ka falënderuar fillimisht presidentin e Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, anëtarët e bordit të FHK-së dhe sekretarin e përgjithshëm Izet Gjinovci për besimin që kishin për të dhe mundësinë që i japin për ta marrë drejtimin e Përfaqësueses së Kosovës. “I falënderoj për mbështetjen e pandalshme ndaj meje dhe ekipit. Gjithmonë kanë punuar me vullnet të madh që të

na i sigurojnë kushtet e duhura për të shkëlqyer. Dhe ne me të vërtetë shkëlqyem. Falënderoj edhe zyrtarët e federatës për përkrahjen e palodhshme në administrimin e ekipit”, ka thënë ai.

Taip Ramadani më pas ka falënderuar edhe trajnerët që ka bashkëpunuar gjatë këtyre viteve, anëtarët e klubeve dhe shoqatave, dashamirët e hendbollit, gazetarët, dhe djemtë e përfaqësueses. “Ishte një hyrje e zjarrtë në hendbollin e Kosovës për mua. Fillim i dështuar. Kurrë nuk kisha përjetuar më parë që nga zhgënjimi i madh i publikut palestra të zbrazej para se të përfundonte pjesa e parë.

Prishtina shkatërroi Arbërinë, sot zhvillohen dy ndeshje

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Skuadra e Arbërisë nuk ka arritur t'i bëjë ballë Prishtinës, pasi ka pësuar humbje me rezultat 0-4. Vendësit janë mbajtur vetëm nëntë minutave lojë, pasi Leonit Abazi realizoi për 0-1. Abazi tregoi formë të lartë në këtë ndeshje dhe pas dymbëdhjetë minutave lojë e shënoi edhe golin e dytë. Në minutën e 37-të, Leoutrim Kryeziu e realizoi golin e tretë dhe të fundit në ndeshje. Në pjesën e dytë, rastet nuk munguan, por ishte skuadra kryeqytetase që realizoi edhe golin

e katërt nëpërmjet Besnik Krasniqit. Prishtina me tri pikët e reja ngritën në kuotën e 38 pikëve, derisa Arbëria mbetet në kuotën e 22 pikëve. Sot (e shtunë), zhvillohen dy ndeshjet e radhës për javën e njëzetë në elitën e futbollit të Kosovës. Kampionia në fuqi, Drita, e pret Trepçën '89 me synim që ta nisë sezonin pranveror me fitore. Mitrovicasit do të mundohen që nga Gjilani të rikthehen të paktën me një pikë. Në ndeshjen tjetër, Drenica e pret Besën e Pejës. Të dielën zhvillohen

dy ndeshjet e fundit për këtë xhiro dhe takohen: Ballkani-Feronikeli dhe Llapi-Gjilani.

SUPERLIGA - Java 20

Arbëria - Prishtina 0-4
Të shtunën takohen:
13:00 Drita - Trepça '89
13:00 Drenica - Besa

Të dielën takohen:
13:00 Llapi - Gjilani
13:00 Ballkani - Feronikeli



Akil Gjakova dhe Laura Fazliu mbesin pa medalje në Izrael

TEL AVIV, 19 SHKURT - Akil Gjakova është ndalur në raundin e tretë të Grand Slamit të Xhudos që po mbahet në Tel Aviv të Izraelit. Xhudisti pejan u mposhtë nga italiani Giovanni Esposito, në shënim

të artë, kategoria deri në 73 kilogramë. Paraprakisht, Akili kishte mposhtur me ippon portugezin Joao Fernando, ndërsa raundin e parë e kaloi pa luftë. Gjakova shtoi në llogarinë e tij 120 pikë

olimpike. Të premtën garoi edhe Laura Fazliu në kategorinë deri në 63 kilogramë. Ajo u ndal në raundin e dytë, duke u mposhtur nga Lucy Renshall e Britanisë së Madhe me shënim

të artë. Fazliu fitoi 100 pikë olimpikë. Ekipi ynë i xhudos mori pjesë në Grand Slam me tre xhudistë, ndërsa do të kthehet me medaljen e bronzit të fituar nga kampionia olimpikë Majlinda Kelmendi.



'Dardanët' ende shpresojnë në kualifikim

PRISHTINË, 19 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll të enjten pësoi humbje nga Luksemburgu, por ende ka gjasa që të kualifikohet tutje. Megjithatë tash gjërat janë vështirësuar për "dardanët", të

cilëve iu duhet shumë fat për ta arritur këtë synim. Sot (e shtunë) do të zhvillohen ndeshjet e fundit në Grupin B, në kuadër të parakualifikimeve evropiane në Kupën e Botës 2023. Luksemburgu do të përballet me

Islandën, ndërsa Kosova me Sllovaqinë. Islandezët janë kualifikuar tutje, sepse kanë katër fitore dhe një humbje, ndërsa Luksemburgu, Sllovakia dhe Kosova kanë nga shtatë pikë, apo dy fitore dhe tri humbje. Për

t'u kualifikuar tutje "dardanët", duhet të mposhtin Sllovaqinë, por edhe për të shpresuar që Luksemburgu do të mundet nga Islanda. Të shtunën takohen: Luksemburgu-Islanda (16:00), Kosova-Slovakia (19:00).



Lakersat pasojnë humbje, fitojnë Toronto dhe Miami

LOS ANXHELOS, 19 SHKURT - Los Angeles Lakersi nuk po arrin t'u japë vazhdimësi rezultateve pozitive, pasi ka pësuar një tjetër humbje, këtë herë në "Staples Center" përballë një kundërshtari mjaft të fortë si Brooklyn Nets. Këta të fundit konfirmojnë sërish momentin pozitiv, pasi dominuan tre fraksionet e para ndaj Lakersave dhe ndonëse humbën pjesën e fundit, ia dolën të triumfojnë me rezultatin final 98-109, duke u ngjitur në vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. LeBron Jamesi ishte më i miri i ndeshjes në parketin e "Staples Center" me 32 pikë të shënuara, 8 rikuperime dhe 7 asistime, megjithatë kjo nuk mjaftoi që Lakersat ta shmangë humbjen, ndërsa për Netsin bën një ndeshje mjaft të mirë James Hardeni dhe Harris. Pas tri humbjeve radhazi, Miami Heat është rikthyer te suksesi, pasi ia doli të triumfojë me shifrat 110-118 në transfertën ndaj Sacramento Kingsit. Në



parketin e "Golden 1 Arena"-s spikati Tyler Herro, që shënoi 27 pikë, ndërsa Miami zgjidhi gjithçka që në gjysmën e parë të ndeshjes. Në harkun kohor të 8 ditëve Sacramento Kingsi pësoi humbjen e 5-të radhazi, ndonëse të gjitha këto takime i ka zhvilluar në "Golden 1 Arena" në shtëpi dhe tani e sheh veten shumë larg zonës së "play-off"-it, raporton "Supersport". Në sfidën tjetër

të mbrëmjes, Toronto Raptors ia doli të triumfojë me rezultatin 96-110 në transfertën ndaj Milwaukee Bucksit. Në "Fiserv Arena" kanadezët mbajtën avantazhin gjatë gjithë kohës, falë edhe formës së mirë të dyshes Siakam-Powell, ndërsa greku i Bucks, Giannis Antetokounmpos, nuk arriti të ngjitet në nivelin e pritshmërive.

Zidane: Mbappe - Haaland si Messi - Ronaldo

MADRID, 19 SHKURT - Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka folur në lidhje me Kylian Mbappe dhe Erling Haaland, dy yje të futbollit botëror të lidhur me një transferim të mundshëm te Reali. "A më pëlqen Mbappe? Shikoj të gjitha ndeshjet dhe kënaqem kur shoh gjëra të bukura, siç ndodh me të gjithë tifozët. Mbappe e Haaland, pasuesit e Messit dhe Ronaldos? Do të shohim. Ata janë shumë të mirë, sikurse Messi, Ronaldo e Neymar. Janë lojtarë të rinj, të së tashmes dhe të ardhmes. A i kam thënë Perezit të firmosë me Mbappen? Nuk i kam dërguar asnjë mesazh. Tifozët kanë të drejtë të kenë një mendim, natyrisht", ka thënë Zidane.



Cassano: Ronaldo është pak egoist

Antonio Cassano e ka quajtur Cristiano Ronaldo 'egoist' dhe beson se ylli i Juventusit po lufton të përshtatet me stilin e lojës së Andrea Pirllos. Ronaldo ka qenë lojtari më produktiv i gjigantëve

të Torinos këtë sezon, duke shënuar 23 herë në 27 paraqitje deri më tani. "Unë gjithmonë kam thënë, edhe pse ai është një fenomen dhe ka shënuar një miliard gola, me idenë e Andrea

Pirlos për futbollin ai mund të hasë në vështirësi. Ai shënon një gol për ndeshje, është e vërtetë, por ai lufton me idenë e Andreas. Ai ka qenë gjithmonë pak egoist", ka thënë Cassano. "Ai është lloji i

lojtarit që jeton për të shënuar, jo për lojë, për ndeshjen e shkëlqyeshme. Ai jeton për të shënuar dhe në këtë moment situata po përkeqësohet. Vitet kalojnë për të gjithë dhe ai ka

vështirësi. Paradoksi është që Juventusit ka blerë një lojtar i cili ka fituar pesë liga të kampionëve, por ka qark shumë vështirësi në Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Cassano.

SHKURT

Nadali: Nuk do të shkatërroj veten për ta thyer rekordin e Federerit

Rafael Nadal nuk arriti ta thyjë rekordin e 20 grand slameve që ai dhe Roger Federeri ndajnë së bashku. Tenisti spanjoll u eliminua dy ditë më parë në çerekfinalin e Australian Openit, ndaj parakalimi që ai synonte të bënte ndaj Federerit është shtyrë për më vonë. "Mendoj se është e drejtë që një njeri të ketë ambicie, por për t'ia dalë mbanë duhet të jetë i shëndetshëm. Nuk duhet që ajo ambicie të të shkatërrojë, për ta arritur me çdo kusht. Unë nuk do të 'vras veten' për ta thyer rekordin e Rogerit", ka thënë Nadal. "Nuk jam afruar kurrë në këtë sport duke menduar ashtu. Unë luaj sipas standardeve dhe mundësive të mia. Dua të kthehem në shtëpi i lumtur se kam dhënë maksimumin në fushë. Në Australian Open ndoshta bëra një gabim, por edhe lodhja bëri të vetën", ka deklaruar Nadal.

Donnarumma: Milani synon titullin

Para derbit më të rëndësishëm të dhjetë vjetëve të fundit, Gianluigi Donnarumma nuk fshihet. Sipas tij, Milani po synon titullin kampion të Serisë A. Portieri i kuqezinjve, i intervistuar nga "Sky Sport", zyrtarisht e vendos ekipin e tij në garën për "Scudetto". Njëkohësisht, ndez supersfidën kundër Interit. "Ne mund të luftojmë për titull, nuk duhet të jemi të kënaqur me më pak. Ndërkohë, qëllimi pa dyshim që mbetet kualifikimi për në Ligën e Kampionëve, diçka që Milani nuk e ka arritur prej shtatë vjetësh. Për mua do të ishte një ëndërr. Nëse bëhet realitet, do të ndodhë sepse e kemi sjellë Milanin përsëri aty ku e meriton", ka thënë Donnarumma. Portieri italian flet edhe për derbin e radhës dhe rrëfen ëndrën e tij për pasditen e së dielës: "Do të kemi një përballje të shkëlqyeshme. Nëse mbyll sytë (ëndërroj), mund ta shoh Ibrahimoviçin duke e vendosur fatin e këtij derbi".

Dy futbollistët e Napolit mposhtin Covidin

Mbrojtësit e Napolit, Kalidou Koulibaly dhe Faouzi Ghoulam, kanë rezultuar negativë pas testit të fundit për Covid-19. Ata ishin infektuar që më 5 shkurt dhe tani dy mbrojtësit mund të llogariten nga trajneri Gennaro Gattuso. "Sapo humbëm Politanon, kështu që çfarë kuptimi ka të kualifikohemi në raundin tjetër nëse nuk kemi me kë të luajmë? Gjithçka që do të bëjmë nesër është t'i numërojmë lojtarët që na kanë mbetur dhe të shohim. Na mungojnë 10-11 lojtarë tani, me Politanon që ka probleme me brinjët dhe nuk merr frymë siç duhet. Nuk mund të ulemi këtu e të qajmë për të, por duhet t'i gjejmë zgjidhjet", ka thënë Gattuso.

Përfundoi sezoni për Tolisso

Corentin Tolisso mbyll sezonin te Bayern Munichu. Gazeta "Bild" raporton se në seancën e ditës së djeshme mesfushori është dëmtuar dhe do të mungojë për gjashtë muaj. Francezi ka dëmtuar tendinën kur po godiste topin dhe ulërimat janë dëgjuar deri jashtë. Seanca zhvillohej me dyer të mbyllura, por gazeta gjermane ka zbuluar gjithçka dhe raporton se Tolisso është nxjerrë nga fusha me një makinë golfi. Kjo është hera e dytë që Tolisso pëson një dëmtim të rëndë. Në shtator të vitit 2018 ai pati një problem në ligament dhe humbi gjysmën e sezonit. Në këtë mënyrë Flick humbet një tjetër element të rëndësishëm të ekipit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020, në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 38/2021 të datës 08 Shkurt 2021, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

K O N K U R S

I. Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Politika

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca: Kodi: KPK/SKPK/POZ- 001
Emri Pozitës: Zyrtar i Lartë Planifikim dhe Politika
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional 1
Raporton tek: Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Nëntë, (9)
Akti i emërimit: Pa afat
Puna provuese: 12 muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ndërmerr iniciativë, hulumton, përgatit raporte analitike si dhe përgatit propozim projekte për nevojat të sistemit prokurorial.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Është përgjegjës për proceset kryesore planifikuese të sistemit prokurorial dhe në veçanti siguron që prioritetet dhe politikat e Institucionit të pasqyrohen në dokumentet përkatëse; Bën hulumtim, analizim dhe planifikim të politikave në zhvillim institucional; Propozon dhe harton metodologjinë për hulumtime që ndërlihen me kualitetin dhe efikasitetin e punës së prokurorive, si dhe harton raporte të avancuara analitike dhe raporte tjera;

Mbledh informata, bën hulumtime, përgatit analiza, jep rekomandime për efikasitetin e sistemit prokurorial në fusha specifike dhe jep iniciativa për ngritjen dhe avancimin e punës sipas standardeve më të larta për sistemin;

Propozon politika dhe bën planifikimet nga fushë veprimtaria përkatëse;

Përgatit draft Plane dhe draft Raportin Vjetor të PSH dhe KPK-së në koordinim me të gjitha njësit organizative përkatëse;

Ofron këshilla në lidhje me rekomandimet që vijnë si pjesë e koncept dokumenteve dhe që ndërlihen drejtpërdrejt me politikat dhe prioritetet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;

Kryen çdo detyrë tjetër që mund të kërkohe nga Mbikëqyrësi.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike, të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;

Njohuri të mira të procesit politik bërjes dhe të planifikimit të përgjithshëm strategjik;

Aftësi të shkëlqyeshme në hartimin e dokumenteve strategjike, politikave, planeve, analizave, raporteve dhe dokumenteve tjera përkatëse;

Aftësi të mira organizative, aftësi pune ne ekip, koordinimi, komunikimi, si dhe aftësi për të punuar nën presion;

Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe në formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power, Point Access);

Të ketë njohuri të gjuhës Angleze si dhe njohja e gjuhëve tjera të BE-së e mirëseardhur;

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare Fakulteti Juridik, Marrëdhënie Ndërkombëtare ose Shkenca Shoqërore.

Përvoja e Punës:

Tri (3) vite përvojë pune profesionale.

II. Referent i Lartë

Prokuroria Themelore Prishtinë, katër (4) pozita

Referenca: Kodi: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 002
Emri Pozitës: Referent i Lartë
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Kodi punës: DR/850
Grada punës: 9
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë
Numri i Pozitave: Katër (4) pozita
Koeficienti: Shtatë (7)
Akti i emërimit: Pa afat
Puna provuese: 12 muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike lidhur me lëndët e pranuar në njësinë organizative ku është punësuar, mban evidenca të sakta dhe me kohë në regjistrin e regjistrimit të lëndëve dhe regjistrin e çregjistrimit të lëndëve sipas kërkesave të specifikuara të vetë regjistrit, kujdesi për lëndët dhe shkresat e lëndëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

